

Dokumentacioni për DËMET MOTORIKE

Për cdo kërkesë për dëmshpërblim
duhet të plotësohen dokumentat
vijuese:



DOKUMENTE TË PËRGJITHSHME:

Njoftimi/Kërkesa

e palës së dëmtuar për dëmshpërblim e regjistruar pranë shoqërisë së sigurimit (postë/email/telefon/kërkesë e drejtëpërdrejtë).

Pala e dëmtuar duhet të plotësojë të gjitha hapësirat e njoftim kërkesës për dëmshpërblim, sipas formatit të miratuar nga shoqëria e sigurimit. Gjithashtu të shpjegojë me hollësi rrethanat e ngjarjes

Konfirmimi i mbulimit në sigurim nga shoqëria e sigurimit, të mjetit - shkaktar të dëmit;

Konfirmimi i mbulimit në sigurim të mjetit shkaktar të dëmit, bëhet nga shoqëria e sigurimit dhe shoqërohet me kopje të policës së sigurimit të mjetit shkaktar të dëmit.

Formulari i Vërtetimit miqësor të ngjarjes;

Formulari i Vërtetimit miqësor të ngjarjes (sipas formatit të miratuar nga Autoriteti), duhet të paraqitet nga pala e dëmtuar.

Formulari duhet të plotësohet me korrektësi dhe besnikëri nga pjesëmarrësit në aksident dhe të jetë i nënshkruar nga këto pjesëmarrës.



Proces verbali i konstatimit të shkeljes nga Policia Rrugore për ngjarjen;

Proces verbali i konstatimit të shkeljes nga Policia Rrugore konsiderohet i rregullt kur ai është lëshuar në përputhje me dispozitat e Kodit Rrugor.

Vendimi i Prokurorisë për ngjarjen, kur në aksident rezultojnë vdekje dhe/ose plagosje të rënda;

Vendimi i formës së prerë i gjykatës (për përgjegjësitë në aksident, kur njëri nga drejtuesit e mjeteve motorike të përfshirë në aksident rezulton me vdekje ose plagosje të rëndë), ose vendimi i prokurorisë kur çështja është pushuar.

DOKUMENTE SPECIFIKE:

Dokumenti i pronësisë së mjetit ose objektit të dëmtuar;

Akt ekspertimi i dëmit;

Akt Ekspertimi i dëmit duhet të hartohet nga specialisti i shoqërisë së sigurimit në vendndodhjen e objektit të dëmtuar, në prani dhe të palës së dëmtuar ose të përfaqësuesit të tij.

Akti i Ekspertimit duhet të hartohet brenda 10 ditësh kalendarike nga data e njoftimit të aksidentit nga pala e dëmtuar.

Akt Ekspertimi i dëmit duhet të jetë i nënshkruar nga të dyja palët.

Foto të mjetit shkaktar të dëmit;

Foto e mjetit shkaktar të dëmit, duhet të paraqesë në mënyrë të qartë targën dhe pjesët e dëmtuara si rrjedhojë e ngjarjes.

Foto të mjetit ose objektit të dëmtuar;

Foto e mjetit ose objektit të dëmtuar duhet të bëhet nga shoqëria e sigurimit që hap dosjen e dëmit gjatë procesit të ekspertimit.

Dosja e dëmit duhet të përmbajë jo më pak se 3 (tre) foto të mjetit/objektit të dëmtuar në pozicione të ndryshme.

Në foto duhet të paraqiten qartë pjesët e dëmtuara, si dhe në një nga fotot të pasqyrohet qartë pamja e përgjithshme e mjetit të dëmtuar së bashku me targën e tij.



 Rruga Dritan Hoxha,
pran ë Pallatit te Sporteve, Larak ë,

 +355 4 220 3330

+355 67 60 48703 

 demet@vig.al